

## **Mbështetje Sektorit Jo-Fitimprurës për t'u Përshtatur me Emergjencën Covid-19**

### **Raport Vlerësimi**

Situata e emergjencës së Covid-19 solli një seri pasigurish për sektorin jo-fitimprurës për sa i përket vijimësisë së financimit (publik ose privat, kombëtar ose ndërkombëtar) si dhe rregullave të distancimit social nën të cilat është vendi, çka e bën gjithë veprimtarinë shumë sfiduese.

Gjatë javës së 23 Marsit, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri kryen një vlerësim të shpejtë të situatës, së bashku me një thirrje publike drejtuar komunitetit të donatorëve në vend për të reaguar ndaj situatës me më shumë fleksibilitet dhe mbështetje specifike për sektorin.

Vlerësimi u përdor si një instrument për të parë:

1. Cili është impakti i situatës në aktivitetet e sektorit? Mund të jetë e vlefshme në orientimin e mbështetësve të sektorit në veprimet dhe reagimet e tyre.
2. Çfarë mund të bëjnë donatorët, për të ofruar më shumë qartësi dhe siguri në lidhje me marrëveshjet aktuale të financimit me sektorin? Është e rëndësishme për sektorin të planifikojë aktivitetet në vijim, duke rishikuar dhe përshtatur proceset e tyre të punës në përputhje me rrethanat.
3. Cilat shërbime dhe produkte që ofrohen aktualisht nga OSHC-të, kanë mundësi për t'u orientuar drejt platformave online?
4. Cilat janë nevojat specifike në lidhje me aksesin dhe aftësitë për të punuar me mjetet online? Të punuarit online është mënyra e vetme për të kryer aktivitetet gjatë kësaj situatë emergjente, dhe sektori jo-fitimprurës nuk është shumë i ushtruar në zgjidhjet e ofruara nga teknologjia e

informacionit. Nevojat e identifikuar në këtë drejtim, mund të ndihmojnë vendimet e donatorëve për mbështetjen që mund të ofrojnë gjatë kësaj periudhe.


Për më tepër, informacioni i mbledhur mbi nevojat për akses në mjete online (pika 4), ka për qëllim orientimin e punës programatike të Partnerëve Shqipëri dhe Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile si dhe të ndihmojë në hartimin e një pakete mbështetëse për sektorin. [Lexoni këtu](#) mbi ndihmën tonë për këtë drejtim.

## OSHC-të pjesëmarrëse në vlerësim

Totali i OSHC-ve të përgjigjura ishte 118 - 22 OSHC që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë, dhe 75 OSHC në 37 Bashki të tjera nga 12 qarqet e vendit.

1 institucion i qeverisjes vendore dhe 1 kompani private nuk u bënë pjesë e analizës.

28 OSHC nga 118 nuk kanë asnjë projekt në zbatim, 65 OSHC kanë nga 1 deri në 3 projekte dhe 25 OSHC kanë mbi 4 projekte.




## 1. Cili është impakti i situatës në aktivitetet e sektorit? Mund të jetë e vlefshme në orientimin e mbështetësve të sektorit në veprimet dhe reagimet e tyre.


Situata emergjente nga Covid-19, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në zbatimin e projekteve por mbi të gjitha ndikon në menaxhimin dhe qëndrueshmërinë organizative duke krijuar probleme me pagat, kostot administrative, kostot e aktiviteteve etj.

Megjithë vështirësitë me të cilat OSHC-të po përballen në menaxhimin e projekteve, 46 OSHC deklarojnë se mund të paguajnë pagat e stafit të tyre dhe 24 OSHC mund të paguajnë një pjesë të pagave. Situata rezulton më problematike në mbulimin e kostove administrative ku vetëm 14 OSHC mund të mbulojnë këto kosto plotësisht dhe 37 prej tyre mund të mbulojnë një pjesë të kostove.

Siç tregojnë edhe rezultatet, 20 OSHC nuk kanë fonde për pagat e stafit dhe 39 OSHC nuk kanë fonde për të mbuluar shpenzimet administrative. Kjo situatë sjell shumë ndërlikime negative dhe ngre një pikëpyetje të madhe për vazhdimësinë e punës së këtyre organizatave, si dhe rrezikon qëndrueshmërinë e tyre. Duke marrë këtë parasysh, nga donatorët nevojitet më shumë fleksibilitet dhe veçanërisht më shumë mbështetje institucionale nga ana e tyre për OSHC-të.




\*Rezultati është përlogaritur bazuar në përgjigjet e 90 OSHC-ve që kanë deklaruar se kanë projekte në zbatim aktualisht



\*Rezultati është përlogaritur bazuar në përgjigjet e 90 OSHC-ve që kanë deklaruar se kanë projekte në zbatim aktualisht

Në situatën aktuale, shumica e OSHC-ve mund të vazhdojnë t'i shërbejnë të gjithë përfituesve të tyre. Vetëm 5 OSHC mund të arrijnë t'u shërbejnë të gjithë përfituesve të tyre.


Një numër i madh i organizatave mendojnë se në këtë situatë, me përshtatjen e metodologjisë, ata mund të arrijnë t'i shërbejnë përfituesve të tyre deri në masën 60%. Kjo tregon se është e domosdoshme përshtatja e shpejtë e metodologjisë së veprimtarisë dhe identifikimit të metodologjive alternative online për të kontaktuar me përfituesit e tyre dhe ofrimin e shërbimeve për ta. 22 OSHC nuk mund të ofrojnë më asnjë shërbim për përfituesit e tyre.




\*Rezultati është përlogaritur bazuar në përgjigjet e 90 OSHC-ve që kanë deklaruar se kanë projekte në zbatim aktualisht

## 2. Çfarë mund të bëjnë donatorët, për të ofruar më shumë qartësi dhe siguri në lidhje me marrëveshjet aktuale të financimit me sektorin? Është e rëndësishme për sektorin të planifikojë aktivitetet në vijim, duke rishikuar dhe përshtatur proceset e tyre të punës në përputhje me rrethanat.

Grupi i OSHC-ve pjesë e këtij vlerësimi, punojnë me një numër të madh donatorësh. Gjithsesi, sikurse mund të pritët, donatorët kryesorë mbeten institucionet e BE (Delegacioni i BE dhe Komisioni Evropian), të cilat aktualisht financojnë 43 OSHC. Donatori i dytë më i madh janë qeveritë e huaja përmes ambasadave të tyre në Tiranë ose Agjencive për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Institucionet shtetërore përmes ministrive të linjës, organeve të qeverisjes vendore dhe AMSHC renditen të tretët.



\*Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë. Rezultati është përlogaritur bazuar në përgjigjet e 90 OSHC-ve që kanë deklaruar se kanë projekte në zbatim aktualisht \*\* Donatorë të tjerë përfshijnë 22 donatorë të ndryshëm të përmendur vetëm një herë.



\*Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë. Rezultati është përlogaritur bazuar në përgjigjet e 90 OSHC-ve që kanë deklaruar se kanë projekte në zbatim aktualisht

Vlerësimi tregon se për 47 projekte nga 159 të raportuara, OSHC-të po vijojnë punën online me një pjesë të aktiviteteve, duke supozuar se donatorët kanë dhënë udhëzime të qarta se si të procedojnë gjatë kohës së karantinës.

Situata mbetet problematike për shumicën e projekteve, 112 në total, për të cilat OSHC-të kanë ndaluar zbatimin e tyre, janë duke pritur për udhëzime nga donatorët ose kontratat e tyre të financimit janë shtyrë. Për 48 projekte, OSHC-të janë ende në pritje të udhëzimeve nga donatorët e tyre.


Në këtë situatë, është tepër e rëndësishme që të gjithë donatorët të kontaktojnë me përfituesit e granteve të tyre dhe të japin udhëzime të qarta për vazhdimësinë e projekteve, dhe rishikimet kontraktuale nëse dhe kur një gjë e tillë është e mundur. Do të rekomandohet që donatorët të marrin me shumë kujdes në konsideratë nevojat e përfituesve të granteve për të siguruar vazhdimin e punës, duke përfshirë këtu edhe mbështetjen institucionale financiare.

Por, le të shohim propozimet e OSHC-ve si zgjidhje praktike ndaj situatës.

- ✓ Sikurse vihet re, shqetësimi kryesor i OSHC-ve ka të bëjë me kostot administrative dhe pagat e personelit gjatë periudhës së karantinës. Pamundësia financiare për të paguar këto

kosto rrezikon të gjithë strukturën institucionale të organizatës dhe krijon pasoja në detyrimet tatimore. Këtu kërkohet një **ndryshim apo rregullim i buxhetit**.

- ✓ Për arsye të kuptueshme, shumica tjetër e OSHC-ve kanë nevojë **për të riplanifikuar aktivitetet e tyre**. Ata do të kenë nevojë të riorganizojnë në një periudhë të shkurtër disa aktivitete, duke marrë parasysh kohën e humbur gjatë tranzicionit midis punës në terren dhe online. Dhe, disa nga aktivitetet e tjera do të duhet të shtyhen për një periudhë të mëvonshme, pasi puna online nuk u përshtatet grupeve të synuara të tyre (Romë, grupe të marginalizuara, komunitete në zona të largëta pa akses në internet dhe teknologji) ose llojit të shërbimeve që ata ofrojnë.
- ✓ Ka OSHC që për shkak të llojit të shërbimeve që ata ofrojnë dhe nevojave të grupit të tyre të synuar, mendojnë se disa **ndryshime apo zhvendosje në aktivitetet e tyre të planifikuara** do të jenë më të përshtatshme dhe më të dobishme për situatën.
- ✓ **Ndryshime në metodologjinë e veprimtarisë** është një kërkesë e kuptueshme dhe e arsyeshme në këtë moment, por mesa duket OSHC-të nuk ka marrë ende një aprovim nga donatorët e tyre.




\*Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë. Rezultati është përlogaritur bazuar në përgjigjet e 90 OSHC-ve që kanë deklaruar se kanë projekte në zbatim aktualisht

### 3. Cilat shërbime dhe produkte që ofrohen aktualisht nga OSHC-të, kanë mundësi për t'u orientuar drejt platformave online?

Shumica e OShC-ve janë të angazhuara në më shumë se një lloj aktiviteti dhe janë të përfshira si në ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta si këshillim, trajnim, etj., gjithashtu edhe në aktivitete kërkimore, advokim, etj. Grupet e synuara të cilëve organizatat u shërbejnë janë gjithashtu të larmishme, duke përfshirë kryesisht të rinjtë, gratë, personat me nevoja të veçanta, komunitetin Rom dhe Egjiptian, personat që jetojnë në zonat rurale, OSHC-të e tjera, ndërmarrjet sociale, komunitetet lokale, etj.

- ✓ 75 nga 90 OSHC që momentalisht kanë projekte në zbatim, **ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta dhe produkte** dhe 64 OSHC ofrojnë **trajnime dhe aktivitete për fuqizimin e kapaciteteve**, aktivitete të cilat mund të përshtaten dhe që nëse mbështeten, mund të vijojnë të ofrohen përmes një metodologjie alternative online.
- ✓ Një numër i madh i OSHC-ve mendojnë se nëse përshtasin metodologjinë e tyre të punës, mund të arrijnë të kontaktojnë dhe t'u shërbejnë shumicës së përfituesve të tyre. OShC-të kanë nevojë për më shumë informacion mbi platforma të përshtatshme që mund t'i përdorin për qëllime specifike, si **këshillim, trajnim, mentorim, promovim dhe shitje të produkteve e shërbimeve etj.** Gjithashtu ata kanë nevojë për akses në të tilla platforma.



\*Pyetje me zgjedhje të shumëfishtë. Rezultati është përlogaritur bazuar në përgjigjet e 90 OSHC-ve që kanë deklaruar se kanë projekte në zbatim aktualisht



4. Cilat janë nevojat specifike në lidhje me aksesin dhe aftësitë për të punuar me mjetet online? Të punuarit online është mënyra e vetme për të kryer aktivitetet gjatë kësaj situatë emergjente, dhe sektori jo-fitimprurës nuk është shumë i ushtruar në zgjidhjet e ofruara nga teknologjia e informacionit. Nevojat e identifikuar në këtë drejtim, mund të ndihmojnë vendimet e donatorëve për mbështetjen që mund të ofrojnë gjatë kësaj periudhe.

Sipas OSHC-ve mjetet e bashkëpunimit online dhe aftësitë në përdorimin e tyre, janë thelbësore në këtë moment për të siguruar vazhdimin e punës së tyre (d.m.th., komunikimi dhe koordinimi i brendshëm dhe i jashtëm, fushata edukuese, marketingu, dhe më e rëndësishmja ofrimi i shërbimeve).

Por, vetëm 15 OSHC momentalisht po përdorin disa nga platformat online kryesisht për koordinim të brendshëm, takime me palët e interesuara dhe partnerët, ofrimin e trajnimeve dhe seancave informuese.

Dy janë llojet e nevojave të identifikuar:

#### 1. Zgjidhje të përshtatshme në TI dhe platforma bashkëpunimi online

- ✓ Rreth **60 OSHC** kanë shprehur nevojë të lartë për akses në programe kompjuterike për zhvillimin e takimeve në grupe, trajnimeve dhe konferencave virtuale.
- ✓ Një numër i vogël, rreth **12 OSHC** kanë nevojë për pajisje (p.sh., laptop, tablet) dhe akses në internet që të mund të punojnë nga shtëpia.

#### 2. Mbështetje për rritjen e njohurive dhe aftësive të tjera

- ✓ Menaxhimi i krizave. Strategji për t'u përshtatur me situatën e re, duke përfshirë planifikimin dhe shpërndarjen e burimeve (financiare, burime njerëzore etj); strategji për rishikimin e punës së tyre programatike dhe ndryshim apo zhvendosje të prioriteteve.
- ✓ Përshtatja dhe ofrimi i shërbimeve përmes teknologjisë online.
- ✓ Metoda alternative për ngritjen e fondeve dhe mundësi financimi.